



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PERGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TE BURIMEVE
NJEREZORE

RELACION

**“PËR NJË SHITESË NË VENDIMI NR.31 DATË 23.02.2023 TË KËSHILLIT
BASHKIAK KORÇË PËR KALIMIN E PRONËSISË TË 70% TË TRUALLIT TË
DHËNË PËR NDËRTIM NË FAVOR TË Z. ROLAND ZEGULLAJ, PËR EFEKT
REGJISTRIMI NË REGJISTRIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME”**

Me Vendim nr.31 datë 23.02.2023 Këshilli Bashkiak Korçë ka dhënë dakordësinë për nënshkrimin e kontratës noteriale për kalimin e pronësisë mbi 30% të truallit prej 225 m² të dhënë për ndërtim nga Këshilli i Rregullimit të Territorit Bashkia Korçë me Vendim nr.380 datë 12.09.1998.

Procedurë kjo bazuar në Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.329 datë 22.05.2019 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së Bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi”.

Objekt i kësaj VKM-je janë tokat e dhëna për qëllime ndërtimi nga Bashkitë, ish-komunat dhe ish-këshillat e rretheve, pas datës 10.08.1991 deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr.24/2012 “Për disa ndryshime në ligjin nr.1070 datë 22.04.2010 Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksë mbi të drejtën e përdorimit të tij”.

Përfitojnë nga ky Vendim, midis të tjerësh, edhe subjektet që nuk janë pajisur nga organet vendore me dokumentacion pronësie mbi tokën, por për ta është miratuar të paktën vendimi i këshillit të organit vendor për dhënien e truallit për ndërtim, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi. (VKM 329/2019, Kreu I, pika 3, b).

Pranë Bashkisë Korçë është paraqitur kërkesa nga ana e përfaqësuesit me prokurë të z. Roland Zegullaj, Z.Ardi Fezga “Kërkesë për shlyerje të detyrimit (30%) të prapambetur të tokës së blerë pranë Këshillit të Qarkut”. Bashkëlidhur kërkesës, përfaqësuesi me prokurë Z.Ardi Fezga ka paraqitur:

1. Prokurë e posaçme nr.1108 Rep 598 Kol. Ardi Fejzi Fezga emërohet përfaqësues i Roland Zegullaj.

2. Mandate arkëtimi për 70% të vlerës së truallit.
3. Lejë ndërtimi nr. 27 Prot. + Kërkesë për lejë ndërtimi + Kërkesë për shesh ndërtimi
4. Planimetri e sheshit të ndërtimit.

Në bazë të Kreut II, pika 6 të VKM-së 329 datë 22.05.2019 kriteret për regjistrimin e truallit janë:

1. *Është miratuar vendimi i këshillit të organit vendor për dhënien e tokës për ndërtim, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi.*
2. *Disponohet kontrata apo akti për kalimin e pronësisë mbi tokën, nga organet vendore te përfituesi, i cili duhet të ketë formën:*
 - a. *e një akti noterial kur veprimi është kryer pas hyrjes në fuqi të Kodit Civil të vitit 1994; ose*
 - b. *e një kontrate jonoteriale ose shkrese te thjeshte kur veprimi është kryer para hyrjes në fuqi të kodit civil të vitit 1994*
3. *Është shlyer çmimi i shitjes së tokës (sipas vërtetimit të pagesës) e përcaktuar në aktin e kalimit të pronësisë sipas vlerës në kohën e miratimit të vendimit të këshillit të organit vendor për dhënien e tokës për ndërtim;*
4. *Të disponohet dokumentacioni për ndërtimin e objektit.*

U konstatua mangësi në dokumentacionin e dorëzuar nga Z.Ardi Fezga, **konkretisht likuidimi i 30% të vlerës së truallit dhe akti i kalimit të pronësisë për 30% të truallit.**

VKM-ja parashaikon se “Kur ka mangësi të dokumenteve të parashikuara më sipër, por për subjektin është miratuar të paktën vendimi i këshillit të organit vendor, për dhënien e tokës për ndërtim, regjistrimi i pronësisë, kryhet pasi bashkia të ketë plotësuar mangësitë e dokuemnetacionit, apo të ketë përfunduar procedura e kalimit në pronësi, sipas këtij vendimi”. (Kreu II, pika 6 VKM).

Si dhe sipas pikës 11 të VKM-së 329/2019, kur subjekti nuk zotëron dokumentacionin e plotë të përcaktuar në pikën 6, të sipërcituar, por që ka të paktën vendimin e këshillit të organit vendor për dhënien e tokës për ndërtim, **ka të drejtë ti paraqesë kërkesë bashkisë përkatëse për kryerjen e procedurës së kalimit të pronësisë.** Bashkia procedon me plotësimin e dokumentacionit dhe dërgimin e tij për regjistrim njësoj si në pikën 9.1 të këtij vendimi. Pika 9.1 parashikon se “nëse Bashkia konstaton se për pasurinë dokumentacioni nuk është i plotë por ekziston të paktën vendimi i këshillit të organit vendor për dhënien e tokës për ndërtim ajo procedon sipas rastit

- a) *Duke i kërkuar subjektit përfitues të shlyejë pjesën e mbetur të çmimit të shitjes të përcaktuar në aktin e kalimit të pronësisë*
- b) *Duke thirrur subjektin përfitues për lidhjen e kontratës noteriale për kalimin e pronësisë mbi tokën, nëse ajo nuk është lidhur më parë, pasi të jetë shlyer vlera e plotë e çmimit të shitjes.*

U përcaktua çmimi i shitjes sipas vlerës së referencës në momentin e miratimit të vendimit të këshillit të organit vendor për dhënien e tokës për ndërtim. 30% e truallit të dhënë për ndërtim =

48 600 lekë. Vlerë kjo e likuiduar nga Z. Ardi Fezga (Mandat Arkëtimi OTP Bank datë 31.01.2023 vlerë 48 600 lekë).

Si rrjedhojë, pas miratimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.31 datë 23.02.2023 u nënshkrua kontrata noteriale e kalimit të pronësisë nr.1619 prot. 1162 rep datë 11.04.2023. Kjo kontratë u dërgua në Ashk Drejtoria Vendore Korçë për regjistrim.

Ashk, Drejtoria Vendore Korçë i është përgjigjur kërkesës për regjistrim të kontratës duke i kërkuar subjektit të formalizojë nëpërmjet një kontrate noteriale kalimin e pronësisë për 70% të ngulur të truallit dhënë për ndërtim. Subjekti ka kërkuar pranë Bashkisë Korçë plotësimin e dokumentacionit në bazë të VKM-së 329/2019 duke i kërkuar Bashkisë Korçë formalizimin e kontratës së kalimit të pronësisë edhe për 70% të truallit prej 225 m2.

Si rrjedhojë, i propozojmë Këshillit Bashkiak Korçë të autorizojë nënshkrimin e kontratës noteriale për kalimin e pronësisë të 70% të truallit të dhënë për ndërtimin e objektit “Shtesë sheshi në Drenicë për objektin Magazinë prodhimi, shitje materiale ndertimi te firmes Korca Ndertim Prodhim, Siperfaqja e shteses se objektit 225 m2” nga KRT Korçë, me vendim nr.380 datë 12.09.1998 në favor të z.Roland Zegullaj.

Bazuar në nenin 9 pika 1.2 gërmat a) “njësitë e qeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e tyre të paluajtshme sipas mënyrës së përcaktuar në ligj” dhe c) “e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës” dhe pika 1.6 gërma a) “e drejta e lidhjes së kontratës” si dhe gërma e) “Këshilli i Bashkisë miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve” të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i kërkohet Këshillit të Bashkisë Korçë të autorizojë kalimin e pronësisë së 70% të truallit prej 225 m2 në favor të Z. Roland Zegullaj, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga Z.Ardi Fezgi Fezga, nëpërmjet nënshkrimit të kontratës noteriale, bazuar në VKM-në 329/2019, për efekt regjistrimi në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

Bashkangjitur këtij relacioni:

1. Dokumentacioni i dërguar nga Drejtoria e Arkivave shtetërore vendore. (Vendimi i Këshillit të Rregullimi të Territorit Korçë nr.380 datë 12.09.1998 për miratimin e sheshit të ndërtimit (pika 2, shtesë sheshi në Drenicë për objektin Magazinë prodhimi, për 225 m2).
2. Kërkesë e Z. Ardi Fezgi Fezga. Nr. 616 Prot. date 22.01.2024.
3. Mandatet e arkëtitimit për pagesën e 30% + 40% + 30 % të çmimit të blerjes së truallit.

Drejtoreshë e Përgjithshme
Anxhela (Dishnica) Qeramixhi

Drejtoreshë e DPKZHT
Zhaneta Lubonja

KRYETARI

Sotiraq FILO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
DREJTORIA E PERGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TE BURIMEVE
NJEREZORE

P/VENDIM

Nr _____, datë _____ / _____ /2024

'PËR NJË SHITESË NË VENDIMI NR. 31 DATË 23.02.2023 TË KËSHILLIT
BASHKIAK KORÇË PËR KALIMIN E PRONËSISË TË 70% TË TRUALLIT TË
DHËNË PËR NDËRTIM NË FAVOR TË Z.ROLAND ZEGULLAJ, PËR EFEKT
REGJISTRIMI NË REGJISTRIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME”

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike bazuar në nenin 54 gërma e) të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe bazuar në VKM-në 329 datë 22.05.2019 dhe pas diskutimeve të këshilltarëve :

VENDOSI:

1. Të japë dakordësinë për nënshkrimin e kontratës noteriale për kalimin e pronësisë mbi 70% të truallit prej 225 m2 të dhënë për ndërtim nga Këshilli i Rregullimit të Territorit Bashkia Korçë me Vendim nr.380 datë 12.09.1998, për efekt regjistrimi në regjistrin e pasurive të paluajtshme.
2. Të autorizohet Kryetari i Bashkisë të nënshkruajë kontratën noteriale për kalimin e pronësisë mbi 70 % të truallit me Z. Roland Zegullaj përfaqësuar me prokurë të posaçme nga Z.Ardi Fejzi Fezga.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

ANA VERUSHI

Miraturar me _____vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____

Bashkia Korca- Sistemi i administrimit te kerkesave/dokumentave
administrativ

Kerkesesi i sherbimit Qytetar Biznes Punonjes

R. P. 10/2024

ID e qytetarit H20828045L

Emer Atesi Mbiemer: Ardi Fezga
Datelindja: 28.08.1972

Adresa: Lgj. 15, Rr: "Gaço Avrazi"

Tel: 0697782927

Email:

Kategoria e sherbimit Sherbime Qendrore - Central LGU Office

Sherbimi i kerkuar Kerkesa/ankesa ne lidhje me problematika te ndryshme te qytetarëve (kur paraqiten ne sportet

Nr. Regjistri/Protokolli 616 22 01 2024

Pershkrim i sherbimit Ky sherbim siguron pikën e parë të kontaktit për qytetarët që kanë kërkesa ankesa të shkruara ose verbale.

Koha e sherbimit 15 dite

Tarifa e sherbimit 0 LEK

Dokumenta te nevojshem * Dokument Identifikimi;
 Në varësi të kërkesës apo ankesës kërkohen dokumenta bashkengjitur.

Eshite kryer kontrolli per detyrimet e taksave? * Kerkesa per plotesim dokumentacioni ne baze te VKM nr. 329/2019 per 70% e ngelur per truallin dhe shtepine.

Shenime

Data e kerkeses

22.01.2024

Sektori per Informimin Qytetar

Nadiola Dalla

Aplikuesi

Ardi Fezga



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE KORCË

NOTER BLEDAR E. ZAKE
ADRESA Lagje Nr.6, Rr. 28 Nentori,
Godina Nr.3
TEL: 0694086756

KONTRATË SHITJE PASURI E PALUAJTSHME

Nr. repertori: 1619

Nr. koleksioni: 1162

Korce më 11/04/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2023033560119839920



A2023033560119839920

KONTRATE SHITJE PASURI E PALUAJTSHME

(truall)

Sot, me date 11.04, 2023 para meje Noter BLEDAR E. ZAKE, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore KORÇË, me zyrë në adresën Korçë, Lagje Nr.6, Rr. 28 Nentori, Godina Nr.3, u paraqit personalisht:

SHITES: BASHKIA KORÇË, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS K54105075C, me adresë Korçë, përfaqësuar nga Administratori **Sotiraq Filo**, atësia Melka, amësia Vasilika, shtetas Shqiptar, lindur në Korçë dhe banues në KORÇË, me adresë Alqi Kondi 02330020; Nd. 36; H. 1; Korçë; Korçë; 7002; Korçë, lindur më 23/06/1971, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035928134 dhe nr. personal H10623034K. (këtu e më poshtë, për efekte të kësaj kontrate referuar si **Shitës**).

BLERES: Roland Zegullaj, atësia Izet, amësia Shyqyrije, shtetas Shqiptar, lindur në Korçë dhe banues në Korçë, me adresë L.5 Rr.Ismail Latifllari; Nd. Nr.4; Korçë; Korçë; 0000; Korçë, lindur më 26/04/1951, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me ID nr. 036906175 dhe nr. personal F10426018M, përfaqësuar me prokurë të tipit "Prokure e posaçme" me Nr. Rep 1108, Nr. kol 598, në datë 21/08/2010, nga përfaqësues Ardi Fezga, atësia Fejzi, amësia Mine, shtetas shqiptar, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, me adresë Tish Daija; Nd. Pall 32; H. Shk 14; Ap. Apt 19; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia bashkiake nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 28/08/1972, gjendja civile i martuar, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova nga karta e identitetit me nr. personal H20828045L (këtu e më poshtë, për efektet e kësaj kontrate referuar si **Blerësi**).

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 83, 705 e vijues i tij, ligjit nr. si dhe ligjit nr. 111/2018 "Për Kadastrën", neneve 62, 63, 105, 106, 108, 126, 127 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noteri hartimin e Kontratës së Shitjes Pasuri e Paluajtshme - Truall, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Neni 1

Baza Ligjore e Kontratës së Shitjes është:

- Kodi Civil, nenet 83, 164, 192, 705, dhe 750 e vijues;
- Kodi i Familjes, nenet 73, 74/a e vijues;
- Ligji 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", nenet 105/3, 105/4, 105/5 neni 127 e vijues;
- Ligji nr. 111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", neni 42 e vijues;
- Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- Ligji Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave Vendore", i ndryshuar
- Udhëzim i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.20 datë 14.09.2020 "Për procedurën teknike për kryerjen e pagesës në rastet e kalimit të pasurive të paluajtshme",
- Udhëzimi nr. 29 datë 30.07.2018 "Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë se paluajtshme"

Neni 2

Objekti i kontratës

SHITESI Bashkia Korçë, përfaqësuar nga Kryetari Sotiraq Filo, deklaron se ka në pronësi të tij 30% të nje trualli të ndodhur në qytetin e Korçës, me sipërfaqe totale 225 m², sipas planit të rilevimit



A2023033560119839920

shkengjitur. Keshilli Bashkiak Korce, me vendim nr 31, date 23/02/2023 dhe ne baze te VKM. 29, date 22.06.2019" Per percaktimin e rregullave te bashkerendimit te punes se Bashkive me Gjencine Shteterore te Kadastres, per regjistrimin e trojeve te dhena per ndertim nga njesite e qeverisjes vendore dhe per rregullimin e marrdhenieve juridike te pronesise mbi keto troje, per efekt regjistrimi", vendosi te miratoje kalimin e pronesise ne favor te blesit Z.Roland Zegullaj, per efekt regjistrimi ne regjistrin e pasurive te paluajtshme.

Shitesi deklaroi se pasurine Truall qe ka ne pronesi te tij ja shet blesit dhe blesesi nga ana e tij deklaroi se eshte plotesisht dakort ne blerjen e trualli te saktësuar me lart.

Neni 3

Vlera e shitjes

Vlera e shitjes per pasurine e saktësuar me lart eshte me vlere **48.600 Leke** (dyzet e tete mije e gjashteqind Leke)

Neni 4

Menyra e pageses

Vlera totale e shitjes prej 48.600 (dyzet e tete mije e gjashteqind) Leke, eshte likujduar sipas manadat pagesave bashkengjitur.

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHITËSIT

Neni 5

SHITËSIT garantojne pronësinë e tyre të plotë mbi pasurinë e paluajtshme, objekt i kësaj kontrate shitjeje, si dhe garanton se prona është e lirë nga barra e cfarëdolloj natyre, vese, detyrime fiskale, të drejta apo pretendime të të tretëve, hipoteke apo transkriptime dhe kufizime.

SHITËSIT jane te detyruar te dorezoje sendin (Truall) te permendur me lart Blesit mbas nenshkrimit te kesaj kontrate.

SHITËSIT detyrohen te lejoje Blesin te gezoje lirisht sendin objekt i kesaj kontrate pa asnje pengese.

SHITËSIT jane te detyruar te paguaje tatimin për transferimin e pasurisë së paluajtshme qe është në ngarkim të Shitësit, i cili merr përsipër të paguajë këtë shumë përpara transkriptimit të pronës në Kadaster Korce .

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E BLERESIT

Neni 6

BLERESI detyrohet te paguaje Shpenzimet për kalimin e pronësisë së pasurisë Truall objekt i kesaj kontrate, shpenzimet noteriale dhe të regjistrimit të Tij në Kadaster Korce.

Rregjistrimi në Zyrën e Kadastres.

Neni 7

Palet u vune ne dijeni se kete kontrate duhet ta regjistrojne brenda 30 diteve dhe te paguaje tatimin, ne baze te ligjit mbi te ardhurat personale ne Republiken e Shqiperise si dhe udhezimeve perkatese dhe akteve te tjera nenligjore, Tatim i cili i takon pales shiteses.

Zgjidhja e mosmarrveshjeve

Neni 8

Palët bien dakort që cdo mosmarrveshje që mund të lindë nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim. Në rast të kundërt Palët do t'i drejtohen për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Korce.

DISPOZITA TË FUNDIT

Pas nenshkrimit te kesaj kontrate asnjera nga palet nuk ka te drejte te kerkoje zgjidhje apo ndryshime te kesaj kontrate ne menyre te njeaneshme.

Pala Shiteses humbet te drejten e pronesise nga momenti i redaktimit e nenshkrimit te kesaj kontrate, te drejte pronesie te cilen e fiton pala blesese, mbasi me pare te regjistrohet kontrata ne Zyren e Kadastres Korce .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. _____ Prot.

Korçë, më ___ / ___ /2023

LËNDA: Njoftim për përmbushje detyrimi

ELIVERTA DURO

Lagjia 4, Rr.Kostandin Kristoforidhi, Nr.4, H.3
KORÇË

Bazuar në kontratën e qirasë nr.381 Rep. 187/3 Kol. datë 18.02.2019 për dhënien me qira të sipërfaqes prej 10.8 m2, me nr.pasurie 2/801/5 Vol.52 Fq.233 ZK 8561 me adresë në Ish Mapo, pasuri e llojit truall, në pronësi të Bashkisë Korçë, ju rezultoni debitor për:

- pagesën e detyrimit të qirasë për periudhën: Janar – Dhjetor 2022 në vlerën 3 888 lekë dhe 1 944 lekë qira për periudhën Janar – Qershor 2023. Kamatvonesa e llogaritur është në vlerën 3 256 lekë.

Ju është dërguar fatura nr. 516 datë 06.06.2023 në vlerën 7 786 për periudhën Janar - Dhjetor 2023. Kjo faturë nuk është likuiduar brenda afatit ligjor.

Si rrjedhojë ju kërkohet të paguani faturën e sipërcituar, brenda një **afati 15 ditor**, nga marrja dijani e kësaj shkrese.

Bazuar në nenin 8 të kontratës së qirasë, mospërmbushja e detyrimeve financiare përbën shkak për zgjidhjen e kontratës dhe marrjen në dorëzim të sendit nga pronari. Gjithashtu në rast mos kryerje të pagesave të sipërcituara, Bashkia Korçë do të procedojë me kërkimin e detyrimit në rrugë gjyqësore.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**KRYETAR
SOTIRAQ FILO**



A2023033560119839920

Pala Blerese **Roland Zegullaj**, ne baze te Çerifikates Familjare aktuale rezulton te jete i martuar me shtetasen **Znj/Afërdita Zegullaj**, Duke qene se nuk ka te dhena per regjimin e ndare vetjak te pasurise bashkeshortore rregjistrimi i kesaj kontrate do ti referohet Kodit te Familjes ku bashkeshortja e blesesit **Znj/Afërdita Zegullaj**, behet bashhepronare me 1/2 pjese te pandare ne kete pasuri se bashku me blesesin, i cili dhe ai behet bashkepronar ne 1/2 pjese te pandare.

Kesaj Kontrate i bashkengjiten Kesaj kontrate I bashkangjiten: Plan Rilevimi, Vendim I Keshillit Bashkiak Korce nr 108, date 30.06.2022, Mandat Pagesa, e dokumenta identifikimi.

Kontrata e Shitjes pasuri e paluajtshme u hartua në gjuhën shqipe prej meje Noterit në 4 (katër) kopje, me vlera të njëjta juridike; mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të palëve kontraktuese. Njëra kopje vendoset në arshivën noteriale, një kopje depozitohet në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ASHK, dega vendore Korce për t'u regjistruar dhe dy kopjet e tjerë u vihen në dispozicion respektivisht palëve kontraktuese.

Kontrata e Shitjes pasuri e paluajtshme, u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterit.

Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

SHITES

BASHKIA KORÇË

perfaqesuar nga

Sotiraq Filo

PALËT

BLERES

Roland Zegullaj

perfaqesuar me prokure nga

Ardi Fezga

NOTER

BLEDAR E. ZAKE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. _____ Prot.

Korçë, më ___ / ___ /2023

LËNDA: Njoftim për përmbushje detyrimi

ELONA BUSHO
MOLLAJ, Rr. Rroshanj, Nr.15
KORÇË

Bazuar në kontratën e qirasë datë 24.05.2021 për dhënien me qira të sipërfaqes prej 43.2 ha, ne parcelen nr.28, me emer popullor Musha e Stratoberdhes, pasuri kjo në pronësi të Bashkisë Korçë, ju rezultoni debitor për:

- pagesën e detyrimit të qirasë për periudhën: 24.05.2023 - 23.05.2024 në vlerën 9 000 (*nente mije*) lekë dhe kamatvonesë në vlerën 1422 (*njemije e katerqind e njezet e dy*) lekë, deri me 31.10.2023.

Ju nuk jeni paraqitur pranë Bashkisë Korçë për të tërhequr faturën. Detyrimi nuk është likuiduar brenda afatit ligjor.

Si rrjedhojë, ju kërkohet të paraqiteni pranë Bashkisë Korçë brenda një **afati 15 ditor**, nga marrja dijeni e kësaj shkrese.

Bazuar në pikën 2 të nenit 7 të kontratës së qirasë, në rast mospërmbushje të detyrimit në mënyrë vullnetare, brenda 15 ditëve nga marrja dijeni e kësaj shkrese, Bashkia Korçë do të procedojë me zgjidhjen e njëanshme dhe të menjëhershme të kontratës së qirasë dhe kërkimin e përmbushjes së detyrimit në rrugë gjyqësore.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

Konceptoi: Jurist; K.Jaçe

Miratoi: Drejtore e Përgjithshme; A.Dishnica Qeramixhi

KRYETAR
SOTIRAQ FILO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr 3/, datë 23/02/2023

“PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PRONËSISË SË 30% TË TRUALLIT TË DHËNË PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT "SHITESË SHESHI NË DRENICË PËR OBJEKTIN MAGAZINË PRODHIMI FIRMËS KORÇA NDËRTIM PRODHIM" NGA KRT KORÇË, ME VENDIM NR.380 DATË 12.09.1998 NË FAVOR TË Z.ROLAND ZEGULLAJ, PËR EFEKT REGJISTRIMI NË REGJISTRIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME”

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike bazuar në nenin 54 gërma e) të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe bazuar në VKM-në 329 datë 22.05.2019 dhe pas diskutimeve të këshilltarëve :

VENDOSI:

1. Të japë dakordësinë për nënshkrimin e kontratës noteriale për kalimin e pronësisë mbi 30% të truallit prej 225 m² të dhënë për ndërtim nga Këshilli i Rregullimit të Territorit Bashkia Korçë me Vendim nr.380 datë 12.09.1998, për efekt regjistrimi në regjistrin e pasurive të paluajtshme.
2. Të autorizohet Kryetari i Bashkisë të nënshkruajë kontratën noteriale për kalimin e pronësisë mbi 30 % të truallit me Z.Roland Zegullaj përfaqësuar me prokurë të posaçme nga Z.Ardi Fejzi Fega.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI



Miratuar me 26 vota

Vota Pro 26

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 1

Zbardhur më datë 23-02-2023

KRYETAR

Erjon NEXHIPI




REPUBLIC OF ALBANIA
MUNICIPALITY OF KORÇE



Auton Baza

BASHKIA KORÇE
NR 1487/1 PROT
DATA 08/03/2023

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BRENDSHME
PREFEKTI I QARKUT KORÇË

Nr. 200/1 Prot.

Korçë, më 03.03.2023

Lënda: Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit

KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË

Mbështetur në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të vendimeve nr.30, nr.32, datë 23.02.2023 të Këshillit të Bashkisë Korçë, *konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tyre*, bazuar në nenin 3, 8, 9, 34, 54, 55, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.926, datë 29.12.2014 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", i ndryshuar, në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në ligjin nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", në vendimin e Këshillit të Bashkisë Korçë nr.183, datë 28.12.2022 "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025 të Bashkisë Korçë" dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.646, datë 05.10.2022 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të formimit profesional, nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar, sipas procedurave të konkurimit, për kurset e formimit profesional, të organizuara nga institucionet e formimit profesional, të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private".

Lidhur me vendimin nr.31, datë 23.02.2023 "Për miratimin e kalimit të pronësisë së 30% të truallit të dhënë për ndërtimin e objektit "shtesë sheshi në Drenicë për objektin magazinë prodhimi firmës Korça ndërtim prodhimi" nga KRT Korçë, me vendim nr.380, datë 12.09.1998 në favor të z.Roland Zegullaj, për efekt regjistrimi në regjistrin e pasurive të paluajtshme", sqarojmë se ky akt nuk përmbush kriteret për të qënë me karakter normativ dhe njëdhimisht nuk mund të shprehemi apo marrim në shqyrtim vendimin, pasi del jashtë kompetencave të dhëna me ligj.



Adresa: L. 7 Rr. "28 Nëntori", Tel: 08224 2953 , e-mail: Prefekli.Korce@mb.gov.al

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

SHTET 30% + ROLAND ZEGULLAJ 70% DATE ; 05/01/2023


GJELLIMI: KALIM PRONESIE

BASHKIA KORCE DVASHK/ZVASHK KORCE ZONA KADASTRALE: 8563 NUMRI PASURISE: 3/287/1 INDEKSI I HARTES: KO-Q-9
 LLOJI PASURISE: TRUALL SIP.PASURISE= 225.0 m2 SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT= 0 m2 NUMRI KATEVE = 0 NUMRI PEMEVE = 0

x=565918.6
y=4497325.5

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

x=566015.4
y=4497325.5



x=565918.6
y=4497261.8

SH 1:500

x=566015.4
y=4497261.8

SHPJEGUES

KUFIRI SIPAS HARTES KADASTRALE SIPERFAQE = 225.0 m²
 KUFIRI I GJENDJES PER KALIMIT PRONESIE SIPERFAQE = 225.0 m²

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI		NR PASURIE	3/185		
2	LINDJE		NR PASURIE	3/607		
3	JUG		NR PASURIE	3/287		
4	PERENDIM		NR PASURIE	3/168		

REALIZOI PER BASHKINE KORCE

EMRI: ERMAL GJERMANI, Arbër GREMI
LICENCA: NR.T.0336/3; DATE 19/12/2017

NENSHKRIMI / VULA
Emri: ERMAL GJERMANI
Date: 2023.01.06
11:53:20 +02'00'

MIRATOI

DREJTORI: ZHANETA LUBONJA
NENSHKRIMI / VULA

Arbër Gremi

Zhaneta Lubonja

KONFIRMOI

KRYETARI I BASHKISE: SOTIRAQ FILO
NENSHKRIMI / VULA

Sotirraq Filo

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Z- G

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT: P; HK

Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesëri PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

Referuar (VKM-ja nr 329/2019),

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI: _____
NENSHKRIMI _____

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale

Ka. 28. Prot.

LEJE NDERTIMI

Koncedohet nga KRT-së të Rrethit Korçë nr. 394 datë 24.10.1998, Vendimit të KRT-së të Rrethit / Këshillit të Bashkisë / Komititetit nr. 380, datë 12.09.1998, për dhënien e lejes së ndërtimit dhe në bazë të kërkesës suaj të datës 17.12.1998 ju jepet leja e ndërtimit për objektin Aktiviteti i punës të zyrave të shërbimit "Korça - Ndërtimi - Prodhe" sipas projektit të miratuar.
Ju jepet Fizama "Korça - Ndërtimi - Prodhe" me licencë
(Emërtimi i subjektit që zbaton punimet, nr. Dhe data e licencës) JE410304SR

Koncedohet nga: Zolaud Rexullaj

(Emërtimi, emri mbiemri i financuesit)

Emërtimi i objektit do të bëhet nga: Firma e Ushqimtarëve në Bashkinë Korçë
Financimi i themeleve u kontrollua nga: _____

Frederik MICO

KRYETAR I KESHILLIT TE RRETHIT

Koncedohet dhe angazhohem të zbatoj të gjitha dispozitat e parashikuara në ligj.

Emri, Mbiemri

Emërtimi, Vula

Fizama "Korça - Ndërtimi - Prodhe"

KERKESE PER SHESH NDERTIMI (SHITESË)

Zyrës së Urbanistikës në RAJONIN DUKAGJIN

1. Emri Mbiemri \ Emërtimi ROLAND ZECULLAJ
2. Adresa TEL UNAZA (LUMI DRENICE)
3. Shtetësia SHQIPTAR
4. Data e dorëzimit të kërkesës 17.12.1997
5. Adresa e sheshit që kërkohet TRAKE LUMIT DRENICE
6. Sipërfaqja e sheshit (SHITESË) 225 m²
7. Sheshi kufizohet nga :


Veriu RRUCE (UNAZA)
 Jugu LUME
 Lindja SHESH
 Perëndimi FIRMA FORSA KOLEKTIVE PECOHAJ

8. Sheshi kërkohet për ndërtimin e objektit MAGAZINE PRODHIMI SHË SHITJE
 me volum të përafërt (m³) MATERIALE A BERTIMI
 me sipërfaqe ndërtimi (m²) 225 M²
 me lartësi kryesore (m) 0.5 (m)
 me numër katësh 2 (dy) kat
 me vlerë të përafërt (lekë \ dollarë) 10000 \$

BASHKANGJITUR KERKESES DUHEN TE DOREZOHEN EDHE KETO DOKUMENTA

1. Dokumenti kadastral i hipotekuar për pronësinë e sheshit
2. Dokumenti bankar për ngurtësimin e 15 % të vlerës së përafërt të objektit

KERKUESI
 (Emri Mbiemri)

ROLAND ZECULLAJ

 Emërtimi i autorit

Mendimi i zyrës së urbanistikës _____

DEBITORI	NUMRI I LLOGARISE
<i>Qyrtëtarë dhe të tjerë</i>	<i>652/24/11</i>
KREDITORI	NUMRI I LLOGARISE
<i>Dega Të arant</i>	<i>43411</i>
PER <i>si paguar vlefshme e 40% të bruto të prej 22500</i> <i>Lecë</i>	
VENDI	DATA
<i>Lecë</i>	<i>22 janar 1999</i>
URDHERUESI (EMRI MBIEMRI)	VULA DHE NENSHKRIMET E BANKES
<i>Roland Zepulli</i>	BANKA E KURSIMEVE KORÇE 27.01.1999 361/600 A

MJD. 5	BANKA E KURSIMEVE	URDHERXHIRIMI I BRENDSHEM
NR. 225624		LAJMERIM DEBITIMI 2
SERIA A/95	VALUTA	LEKE
	<i>64800</i>	
KOMISIONE BANKARE	<i>100</i>	
GJITHSE!	<i>64900</i>	
(<i>qyrtëtarë dhe të tjerë e kates rreze e të tjerë</i>) LEKE		
DEBITORI	NUMRI I LLOGARISE	
<i>Lecë Mollëtim Produktiv Lecë</i>	<i>652/24/11</i>	
KREDITORI	NUMRI I LLOGARISE	
<i>Dega Të arant Lecë</i>	<i>43411</i>	
PER <i>si paguar vlefshme e 40% të bruto të prej 22500</i> <i>Lecë</i>		
VENDI	DATA	
<i>Lecë</i>	<i>22 janar 1999</i>	
URDHERUESI (EMRI MBIEMRI)	VULA DHE NENSHKRIMET E BANKES	
<i>Roland Zepulli</i>	BANKA E KURSIMEVE KORÇE 27.01.1999 361/600 A	

GELIS 07-930-10-95 AMU-2

Shënim: Banka nuk merr përgjegjësi për gabimet që rrjedhin nga instruksionet e gabuar të urdheruesit.